“Ç'është puna e disave që gjatë namazit ngrenë shikimet nga qielli?” Më pas, Profeti ﷺ u ashpërsua, saqë tha: “Le të ndalen prej këtij veprimi, në të kundërtën, do t'u verbohen sytë.”

Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Ç'është puna e disave që gjatë namazit ngrenë shikimet nga qielli?” Më pas, Profeti ﷺ u ashpërsua, saqë tha: “Le të ndalen prej këtij veprimi, në të kundërtën, do t'u verbohen sytë.”

[Sahih] [Transmeton Buhariu]

Profeti ﷺ i paralajmëroi ata që i ngrenë sytë kah qielli gjatë namazit, qoftë gjatë lutjes apo në raste të tjera. Qortimi i tij u bë edhe më i ashpër dhe ai ﷺ i kërcënoi se shikimi i tyre mund t’u merret me shpejtësi, deri në atë pikë sa të mos e kuptojnë fare, derisa ta kenë humbur dhuntinë e të parit.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/10883